



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.10.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01.10.2018.
2. Miratimi në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale””.
3. Miratimi në tërësi i projektligjit “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Vullnet Sinaj, Klodjana Spahiu, Milva Ekonomi, Paulin Sterkaj dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Anduel Xhindi, Sadi Vorpsi, Luan Rama, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunkshi, Isuf Çelaj.

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare.

Në mbledhjen e sotme të komisionit kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 01.10.2018 dhe miratimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale””. Gjithashtu, duhet të miratojmë në tërësi edhe projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Lidhur me dy projektligjet e mësipërme, ne i kemi diskutuar në parim dhe nen për nen, si dhe janë bërë reflektimet dhe sugjerimet përkatëse në raport. Kështu, ju ftoj të votojmë për secilën pikë të rendit të ditës.

Kush është dakord pikën e parë të rendit të ditës, me procesverbalin e datës 01.10.2018? Kundër Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale””? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet!

MBYLLET MBLEDHJA